



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.12.2020, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 09.11.2020, 17.11.2020 dhe 20.11.2020.
2. Miratimi i kalendarit të Komisionit të Integrimin European për periudhën 30 nëntor – 25 dhjetor 2020.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Mal i Zi – Shqipëri 2014-2020 alokimet për vitin 2019”.
5. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Kosove – Shqipëri 2014-2020 alokimet për vitin 2019”.
6. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Maqedoni e Veriut – Shqipëri 2014-2020 alokimet për vitin 2019”.

7. Të tjera

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Arben Kamami, Taulant Balla, Klodiana Spahiu, Mirela Kumbaro, Nikolin Staka,, Fatmir Velaj,, Kostaq Papa, Vasil Sterjovski, Arlind Carcani, Edlira Hyseni, Musa Ulqini, Artemis Mara, Sadri Abazi, Ilir Pendavinji

Të ftuar:

Vasilika Vjero – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ergys Misha - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elvis Koçi - Drejtor i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Delina Ibrahimaj - Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve

Zef Mazi – Kryenegociator nga Ministria e Europës dhe Punët e Jashtme

Redih Lleshi - Drejtor i Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s në Ministrinë e Europës dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Senida Mesi - Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë sot me rendin e ditës në Komisionin e Integritetit Europian.

Sikurse të gjithë e keni marrë agjendën, të njoftuar me anë të postës elektronike, kemi miratimin e procesverbaleve të datave 09.11.2020, 17.11.2020 dhe 20.11.2020. Më pas kemi miratimin e kalendarit të Komisionit të Integritetit Europian, për periudhën 30 nëntor – 25 dhjetor 2020, si dhe shqyrtimin e tri projektligjeve: së pari, të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA Mal i Zi – Shqipëri”, së dyti, Kosovë – Shqipëri dhe, së treti, Maqedoni e Veriut – Shqipëri, për vitin 2014-2020 dhe alokimet për vitin 2019. Ndërkohë kemi dhe shqyrtimin e projektligjit “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”.

Kemi prezentë dy të ftuarit për të dyja projektligjet. Në rastin konkret, janë përfaqësuesit e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Kemi prezent kryenogociatorin., zotin Mazi, që e falënderoj që është sot këtu me ne, dhe zonjën Vasilika Vjero, zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave, për projektligjin “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”.

Në fakt, unë kam një pyetje për zotin Mazi, duke e ditur që është pjesëmarrës dhe në Komisionin e Ligjeve dhe ndoshta paralelisht pret dhe aty që të ndërhyjë.

Zoti Mazi, dëshiron që të vazhdojmë në fillim me ju?

Apo kemi shkëputje nga zoti Mazi aktualisht?

Sekretaria, ma konfirmoni, sepse nuk e shoh më zotin Mazi. Ndoshta është futur në Komisionin e Ligjeve.

Nikolin Staka - Është në Komisionin e Ligjeve, kryetare.

Senida Mesi - Dakord.

Vazhdojmë sipas agjendës, me shqyrtimin e projektligjit “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”.

Për këtë projektligj janë të ftuar zonja Vasilika Vjero, zëvendësministre, Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike, Ergys Misha, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore, si dhe Elvis Koçi, drejtor i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Zonja Vjero, fjala është për ju.

Më pas do të doja t'ia kaloja fjalën përfaqësuesve të përafrimit të legjislacionit në Kuvendit të Shqipërisë, me qëllim që të dëgjojmë komentet në lidhje me përafrimin e direktivës përkatëse, për të kaluar më pas në diskutime me secilin nga kolegët deputetë.

Zonja Vjero, fjala është për ju.

Vasilika Vjero - Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje!

Unë do të bëj një përshkrim shumë të shkurtër të përmbajtjes së legjislacionit, duke filluar me faktin pse është i nevojshëm, pse po prezantohet para jush dhe më tej në parlament për miratim.

Në fakt, nevoja për këtë ligj ka lindur si rezultat dhe i rekomandimeve të grupit të posaçëm të veprimit financiar, për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria dhe sigurisht që qenia pjesë e këtij grupi na ngarkon me një sërë përgjegjësish, ku çdo shtet... *(Nuk dëgjohet)*... tyre, të kordinojnë punën, eksperiencat, të shkëmbejnë informacione, gjithmonë, për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizimit dhe armëve të shkatërrimit në masë.

Shqipëria, në fakt, kishte një mungesë në legjislacion dhe kryesisht mungesa lidhej me ligjin e pronarëve përfitues, u cili është miratuar në fund të korrikut. Ky ligj do të duhet të shoqërohet dhe me një ligj tjetër të rëndësishëm, që ka të bëjë me atë të regjistrit të llogarive bankare, i cili prezantohet sot para jush.

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kushteve për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar në Shqipëri, për pastrimin e parave apo dhe të të gjitha produkteve që burojnë nga vepra penale, parandalimi dhe financimi i terrorizimit, apo dhe më tej, me përdorimin e këtij regjistri për lehtësimin e procedurave të mbledhjes së detyrimeve tatimore në nivel qendror, por dhe në nivel vendor, pra për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Regjistri do të përdoret si një instrument për zbulimin ...*(Nuk dëgjohet)* apo dhe shkeljeve në fushën tatimore dhe doganore. Janë një sërë institucionesh, të cilat do të punojnë së bashku dhe i ngarkon ky ligj për të ndërtuar këtë regjistër dhe më tej për të administruar regjistrin, duke filluar që nga AKSHI, që është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e cila është përgjegjëse për krijimin e këtij sistemi. Ndërkohë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në këtë ligj parashikohet se do të jetë institucioni i cili do të administrojë regjistrin, do të vendosë në dispozicion të të gjitha subjekteve të interesuara aksesin dhe informacionin e nevojshëm, të cilin do ta përmbajë ky regjistër i nevojshëm për qëllimet e strukturave, ndërkohë do t'u japë informacion dhe subjekteve të tjera në bazë të një kërkesë, që do

ta shpjegoj më vonë dhe që është e përcaktuar qartazi dhe në këtë ligj. Gjithashtu, do të mbikëqyrë përputhshmërinë e institucioneve financiare me kërkesat e këtij ligji; do të kërkojë nga institucionet financiare dhënien e aksesit për çdo lloj informacioni apo dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj, por dhe mund të kryejë investime; mund të vendosë dhe penalitete, aty ku e shikon të nevojshme, për institucionet që nuk e zbatojnë këtë ligj apo japin dhe informacione të pasakta.

Në fakt, regjistri do të krijohet si një bazë të dhënash shtetërore, ku informacioni do të jetë i grumbulluar, i organizuar në formë elektronike për të gjithë mbajtësit e llogarive bankare dhe kasetave të sigurisë. Informacioni i cili do të ruhet në këtë regjistër nuk është i disponueshëm, nuk është i hapur për publikun. Informacioni...(Nuk dëgjohet) mbyllja...(Nuk dëgjohet) kasetës së sigurisë, mbledhja, përpunimi, administrimi i të gjitha të dhënave i nënshtrohet rregullores dhe rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, pasi në këtë ligj janë reflektuar të gjitha komentet, edhe të institucionit përkatës, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, në fund, pasi ka përfunduar afati i ruajtjes së këtyre të dhënave, këto të dhëna do të fshihen nga regjistri.

Raportimi i të dhënave është një element tejet i rëndësishëm dhe që përcaktohet në këtë ligj, ku edhe vetë institucionet financiare do të duhet që të krijojnë, të administrojnë sisteme për të raportuar të dhëna, të cilat do të jenë në kohë reale. Pra, në momentin kur një mbajtës llogarie apo dhe një individ, një subjekt do të hapë një llogari apo dhe një kasetë sigurie, sigurisht, ky informacion do të transmetohet në kohë reale, pranë këtij regjistri. Institucionet financiare të dhënat do t'i raportojnë gjithmonë në mënyrë elektronike. Mënyra se si ata do të raportojnë, formatet që do të kenë këta skedarë të raportimit, të gjitha këto do të përcaktohen me një vendim të Këshillit të Ministrave dhe gjithmonë në konsultim me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces.

Raportimi pranë institucioneve financiare do të përfshijë të dhënat për llogaritë bankare, kasetat e sigurisë, të cilat janë të mbyllura në 5 vjetët e fundit.

Duke u nisur dhe nga shqetësimet e institucioneve financiare, ku për shumë klientë, qofshin individë apo biznese, mungojnë informacionet e plota, është vendosur që për llogari të mbyllura para datës 1 janar të vitit aktual, institucionet financiare do të raportojnë të dhënat që do të disponojnë. Sigurisht që institucionet financiare janë ato që raportojnë të dhënat dhe janë përgjegjës për saktësinë, plotësinë e të dhënave të raportuara. Megjithatë, në rast se nga ato apo dhe nga strukturat e tjera, që do të përdorin të dhënat e këtij regjistri, do të identifikohen apo do të vërehen pasaktësi, këto pasaktësi do të duhet të raportohen brenda një afati 72-orësh pranë

administratës tatimore.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij regjistri janë dhe subjektet që kanë akses. Këto subjekte janë të ndara në tri grupe: janë subjektet që kanë akses të drejtpërdrejtë, në mbështetje dhe të direktivës, është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave...(Nuk dëgjohet), por niveli i aksesit do të përcaktohet me një vendim të Këshillit të Ministrave dhe këtu janë të përfshirë ...(Nuk dëgjohet) që ligji i ka mirëpërcaktuar. Ndërkohë, është dhe një kategori e fundit, janë subjektet që kanë të drejtë të marrin informacion me kërkesë dhe...(Nuk dëgjohet), të cilat...(Nuk dëgjohet) pasi dhe vetë institucionet financiare apo dhe bankat qendrore sot nuk e kanë një regjistër të tillë dhe ata gjykojnë se, meqenëse po krijohet ky regjistër, edhe ata të kenë mundësi që ta marrin me kërkesë këtë informacion, autoritete të tjera publike, që... (Nuk dëgjohet) përmbartimor shtetëror apo privat.

Për sa u përket të dhënave, janë një sërë të dhënash që do të përmbajë ky regjistër. Unë dua të theksoj, pasi është specifikuar qartazi dhe...(Nuk dëgjohet) u konsultuam që të dhënat e llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë, apo dhe me këto transaksione, nuk do të jenë pjesë e raportimit. Kjo është përcaktuar qartazi dhe në këtë ligj, në mënyrë që të mos krijohen më tej paqartësi gjatë kohës kur ky ligj duhet të aplikohet dhe të zbatohet me institucionet financiare, por edhe me institucionet që do të përfitojnë, apo do të marrin këto të dhëna.

Ka një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, të cilat duhet të hartohen nga Këshilli i Ministrave, por edhe me udhëzime nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë apo udhëzime të brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të cilat janë të përcaktuara qartë.

Nëse do të ndalemi te përafrimi dhe përputhshmëria, ky projektligj është përafruar pjesërisht me direktivën e Bashkimit Europian ...(Nuk dëgjohet)... se sa regjistri i llogarive bankare.

Për sa i takon aspektit të regjistrit të llogarive bankare, ne kemi një përafrim me direktivën në masën 100%.

Zonja Mesi, unë u përpoqa të bëja një përmbledhje, ndoshta të shkurtër. Megjithatë, në çdo moment ne jemi të gatshëm për të sqaruar çdo pyetje apo paqartësi që mund të lindë.

Sot kemi marrë edhe komentet e komisionit për përputhshmërinë dhe pothuajse jemi dakord me të gjitha, ndërkohë që drejtori ligjor, Sajmiri, kishte vetëm një sqarim. Ne e kemi dërguar me shkrim, por nëse gjykoni se duhet ta prezantojmë kështu, mund t'i kalojmë fjalën drejtorit ligjor të Ministrisë së Financave, për të bërë shpjegimin.

Senida Mesi – Shpjegimi lidhet me rekomandimet e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, zonja Vjero?

Vasilika Vjero – Po, sepse na erdhën sot me shkrim të dhënat.

Po ashtu, kemi dhënë përgjigje me shkrim, por nëse duhet ta shpjegojmë, Sajmimi e shpjegon shkurtimisht.

Senida Mesi – Para se të kalojmë te Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit, nuk e di nëse dikush, përfaqësues i Ekonomisë së Financave dhe Ekonomisë, apo i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, do të donte të bënte një koment për projektligjin. Megjithatë, zonja Vjero e përgjithësoi dhe dha elemente më të rëndësishme për qëllimet e këtij projektligji dhe se cilat janë risitë.

Nëse nuk ka komente nga ana juaj, do të doja t'i kaloja fjalën, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit, zotit Kasneci.

Zoti Kasneci, urdhëroni!

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar, zonja zëvendëskryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Ministrisë së Financave,

Siç u prezantua edhe nga zëvendësministrja e Ekonomisë dhe Financave, zonja Vjero, projektligji “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” ka dy qëllime kryesore:

Qëllimi i parë është zbatimi i rekomandimeve të dhëna për Republikën e Shqipërisë në raportet e vlerësimit të grupit të posaçëm të veprimit, ai që quhet *Financial Action Taks Force*, për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Qëllimi i dytë lidhet me fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Integritit Europain, është përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Siç u tha edhe nga zonja Vjero, projektligji është përafuar pjesërisht me dy direktiva të Bashkimit Europian, është përafuar pjesërisht me atë që quhet direktiva e 5-të e BE-së, luftës kundër pastrimit të parave, e vitit 2018, e cila amendon dhe plotëson, me rregulla më strikte, edhe atë që quhet Direktiva 4 e BE-së e vitit 2015 për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjithashtu, projektligji është përafuar edhe me direktivën e BE-së, të vitit 2019, që vendos rregulla, të cilat lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të disa veprave penale.

Shërbimi i Përafritit të Legjislacionit në Kuvend, në përmbushje të detyrave të tij funksionale, që ka për të mbështetur veprimtarinë ligjvënëse të Komisionit për Integrimin Europian, ka analizuar përputhshmërinë e projektligjit me nenet përkatëse të direktivave, me të cilat është synuar përafritimi dhe përafritim më korrekt kemi paraqitur në total 4 vërejtje dhe sugjerime.

Përveç vërejtjes së parë, që të shtohet “paravrejtja standarde, numri *select* dhe shënimi në fund të faqes”, ku jepet se me çfarë është përafuar, janë paraqitur edhe tri vërejtje të tjera.

Për ekonomi të kohës suaj, i kemi diskutuar paraprakisht edhe me përfaqësuesit e ministrisë dhe ata shprehin dakordësinë e tyre për to.

Përfaqësuesit e ministrisë kanë bërë vetëm një sugjerim për një nga vërejtjet që kishim për përkufizimin e termit “Regjistri”, që është regjistri qendror i llogarive bankare dhe kasetat e sigurisë. Subjektet, që identifikohen, që mbajnë në llogari bankare kasetat të sigurisë, ne, në linjë me direktivën, kishim vendosur person fizik ose juridik, duke i qëndruar strikt termave të direktivës, që janë “*nacional person* dhe *legal person*”. Me të drejtë, Ministria e Financave sugjeron që termi ekuivalent në shqip i “*nacional person*” është individ dhe termi “*legal person*” është person fizik ose person juridik.

Ne jemi shumë dakord me sugjerimin e Ministrisë së Financave dhe i falënderojmë për mirëkuptimin dhe profesionalizmin.

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Në total, ne kemi sugjeruar 4 vërejtje, të cilat, me shtesën që u paraqit, janë pranuar edhe nga Ministria e Financave.

Faleminderit!

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Kasneci!

Ka sërish komente nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë? Besoj se për anëtarët e komisionit ishte mëse e qartë. Edhe nga ana ligjore, individi është individ dhe dy statuset ligjore, person fizik dhe person juridik, janë për pjesën e individëve që përfaqësojnë kompanitë.

Besoj se kjo është shumë e qartë. Nuk e di nëse Sajmiri do të donte të shtonte diçka, por nëse jo, do të doja ta kaloja fjalën për pyetje dhe diskutime kolegëve deputetë për këtë projektligj.

Shikoj që ka ngritur dorën zoti Ralf Gjoni.

Urdhëroni, zoti Gjoni!

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Përfitoj nga rasti t’ju uroj të shkuara gjatë kësaj kohe të vështirë!

Do të mundohem, dhe u sugjeroj edhe kolegëve, të jemi konciz në ndërhyrjet tona sot.

Zonja Vjero, ju falënderoj për shtjellimin tuaj konciz dhe profesional!

Kam vetëm një pyetje.

Në nenin 14 të këtij projektligji parashikohet përdorimi i të dhënave të marra nga regjistri që do të krijohet. Këto janë të dhëna të natyrës personale dhe projektligji thotë se duhen trajtuar dhe ruajtur si sekret bankar.

Së pari, kush do të ketë të drejtë dhe akses të administrojë këto të dhëna personale dhe këto të dhëna personale, a përfshijnë edhe gjendjen e llogarive bankare personale, apo jo? E dua thjesht për konfirmim. Kam qartësinë time, por dua vetëm një konfirmim nga ana juaj.

Faleminderit!

Senida Mesi – Po, zonja Vjero, meqenëse nuk shikoj kolegë të tjerë që duan të flasin.

Vasilika Vjero – Në legjisacion është përcaktuar qartë se, të dhënat, që do të mbajë ky regjistër, nuk do të ndahen me publikun. Sigurisht, ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, do të veprojë ndaj të gjithë individëve apo subjekteve që do të duhet të transmetojnë këto informacione, të cilat nga bankat, më tej, do të jenë pjesë e këtij regjistri. Ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” prevalon edhe në këtë rast.

Ndërkohë, regjistri *...(Nuk dëgjohet)...* struktura përgjegjëse pëpr krijimin e regjistrave, do të *...(Nuk dëgjohet)...* pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Adminsitrator do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila do të ketë akses në të dhënat e këtij regjistri. Ndërkohë, akses do të kenë edhe një sërë institucionesh të tjera, por forma dhe mënyra e aksesimit do të përcaktohet me një vendim të Këshillit të Ministrave, si *...(Nuk dëgjohet)...* dhe të tjera struktura, që janë të përcaktuara në nenin përkatës.

Akses të pakufizuar në këtë regjistër, dhe në përmbushje të direktivës, do të ketë Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.

Për sa i takon shqetësimin tuaj për *...(Nuk dëgjohet)...* gjendja e llogarive dhe transaksionet e lëvizjes së shumave nga një llogari në tjetrën, nga një subjekt në tjetrin, apo nga një individ, nuk do të jenë pjesë e këtij regjistri. Në ligj është përcaktuar qartë që ky regjistër nuk do të përmbajë të dhëna për gjendjen e llogarive bankare. Më konkretisht, në nenin 8, ku përcaktohen të dhënat e këtij regjistri, duke filluar nga të dhënat për individin dhe të dhënat për subjektet, pika 4, po e citoj, shprehimisht, ligji përcakton: “Regjistri nuk përmban të dhëna mbi gjendjen e llogarive bankare dhe përmbajtjen e kasetave të sigurisë. Institucionet financiare nuk opertojnë të dhëna për gjendjen e llogarive dhe përmbajtjen e këtyre kasetave”. Edhe ky shqetësim, sigurisht që jemi treguar të kujdesshëm, sepse ka pasur shumë institucione me të cilat ne jemi konsultuar, duke filluar që nga institucionet financiare, policinë, SPAKU-n, prokurorinë dhe shoqërinë civile, prandaj më duhet t’ju them se rreth 99% e të gjitha komenteve dhe sugjerimeve janë të reflektuara në ligj. Një prej shqetësimeve ka qenë edhe gjendja e llogarive dhe ne jemi treguar të kujdesshëm që të jetë e specifikuar qartazi me një pikë të veçantë në mënyrë që të mos krijojë asnjë lloj ekuivoku për institucionet financiare, po ashtu edhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si administruese, por edhe për të gjitha strukturat e tjera që do ta marrin këtë informacion.

Senida Mesi – Faleminderit, zonja Vjero!

Zoti Gjoni, nuk e di nëse zonja Vjero iu përgjigj pyetjes suaj dhe merakut që ju kishit në lidhje me informacionin se çfarë përmban kasetat, sikurse edhe për shumatat që përmban llogaria, të cilat do të jenë subjekt i këtyre raportimeve. E para.

E dyta, duke ju falënderuar edhe për pyetjen, e cila është mjaft e rëndësishme, të gjitha informacionet e lira janë subjekt i mbrojtjes së të dhënave të konsumatorit. Unë mendoj se është detyrim ligjor i të gjitha institucioneve që të menaxhojnë treguesit në mënyrë që ata të përmbushen dhe le të jenë pjesë e të gjithë detyrimeve ligjore sa i takon mbrojtjes së të dhënave të konsumatorit, si edhe të çdo lloj elementi tjetër shtesë që përmban regjistri.

A keni pyetje dhe diskutime të tjera, të nderuar kolegë!

Nuk ka.

Pa humbur kohë po e kaloj në votim.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen, me komentet dhe 4 sugjerimet që rekomandoi Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit, përfshirë këtu shënimin në fund të faqes për titullin dhe 3

rekomandimet së bashku me sugjerimin e bërë nga të dyja palët, si Ministria e Financave ashtu edhe Ministrisë së Shëndetësisë na sqaruan për individin, pra për personin juridik dhe fizik.

Kush është dakord me ndryshimet nen për nen? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Ju lutem, sekretariati i komisionit sa më shpejt ta dërgoni te Komisioni i Ekonomisë dhe Financave si komision përgjegjës, pasi këtij takimi *online* do të jetë edhe mbledhja e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Zonja Vjero, si dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sajmirit, Delina Brahimit dhe kolegët e tjerë i falënderoj për pjesëmarrjen!

Jeni të lirë të largoheni!

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.12.2020, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Senida Mesi – nënkryetare e Komisionit

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Mal i Zi – Shqipëri 2014-2020 alokimet për vitin 2019”.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Kosove – Shqipëri 2014-2020 alokimet për vitin 2019”.

3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Maqedoni e Veriut – Shqipëri 2014-2020 alokimet për vitin 2019”.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Arben Kamami, Taulant Balla, Klodiana Spahiu, Mirela Kumbaro, Nikolin Staka,, Fatmir Velaj,, Kostaq Papa, Vasil Sterjovski, Arlind Carcani, Edlira Hyseni, Musa Ulqini, Artemis Mara, Sadri Abazi, Ilir Pendavinji

Mungojnë:

Të ftuar:

Zef Mazi – Kryenegociator

Redi Lleshi - Drejtor i Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale për fondet IPA.

Senida Mesi – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Sa i takon kësaj pike të rendit të ditës, për sa kohë kemi marrëveshje të tilla, sepse të tria marrëveshjet janë të një forme dhe të një natyre për fondet IPA për vitin 2014 deri në vitin 2020 me tre shtete: Mali i Zi-Shqipëri, Kosovë-Shqipëri, Maqedoni e Veriut-Shqipëri “Për alokimet e vitit 2019”, do të doja t’i trajtonim të tria në grup, sigurisht me komentet respektive, si dhe me pyetjet e përgjigjet që mund të keni pas prezantimit.

I pranishëm është zoti Mazi, kryenegociator, si dhe zoti Redi Lleshi, drejtor i Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale për fondet IPA.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Pa humbur kohë po ia kaloj fjalën zotit Mazi, për prezantimin e tri marrëveshjeve, problematikave apo rekomandimeve që keni në rastin konkret për Komisionin e Integrimit European.

Zef Mazi – Ju falënderoj për fjalën!

Më vjen mirë që jam i pranishëm sot në Komisionin e Integrimit European. Dua t’ju kërkoj ndjesë për hyrjen dhe daljen nga linja, por ishte një përplasje që e kishte bërë IT-ja e Kuvendit dhe nuk mund ta evitoja dot, sepse nuk mund të isha njëkohësisht në dy vende!

Ata më dhanë një link dhe pastaj më thanë bëj një link tjetër dhe kjo ishte arsyeja që më patë një herë dhe më pas dola nga linja.

Siç e thotë edhe zoti Gjoni, do të përpiqem të jem sa më konciz. Besoj se ju do t’i keni kaluar këto, prandaj do të fokusohem konkretisht vetëm tek alokimet e vitit 2019, për çka janë edhe këto marrëveshje.

Alokimet e vitit 2019 për programin Maqedoni e Veriut-Shqipëri financohen nga granti i BE-së përmes IPA II, me vlerë prej 1,7 milionë euro për të dyja vendet, pa përfshirë bashkëfinancimin kombëtar të të dyja vendeve. Në total kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të këtij programi midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë për periudhën 2014-2020 arrin shifrën 11,9 milionë euro. Alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare midis vendit tonë, Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit European.

Cilat janë zonat që do të përfitojnë nga programi? Në Maqedoninë e Veriut do të përfitojnë rajoni i Pelagonias, rajoni i Pologut dhe rajoni Jugperëndimor. Në Shqipëri qarku i Dibrës, qarku i Elbasanit dhe qarku i Korçës.

Duke marrë parasysh aspektet që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe në zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike:

1. Nxitja e turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore.
2. Rritja e konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve.
3. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i riskut.

Aktualisht ky program ka shpallur dy thirrje.

Alokimet e vitit 2019 për programin Shqipëri-Kosovë financohen përsëri nga një grant i BE-së përmes IPA II, me vlerë 1,2 milionë euro për të dyja vendet. Në total kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Shqipëri-Kosovë për periudhën 2014-2020 kap vlerën 8,4 milionë euro.

Alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare midis vendit tonë, Kosovës dhe Komisionit European.

Cilat janë zonat që do të përfitojnë nga ky program? Nga ky program në Shqipëri do të përfitojnë qarku i Lezhës dhe qarku i Kukësit; në Kosovë rajoni ekonomik Perëndimor dhe rajoni ekonomik Jugor.

Duke pasur parasysh aspektet që ndikojnë në ekonominë e zonës, programi ka në fokusin e tij prioritetet tematike si më poshtë:

1. Mbrojtja e mjedisit, promovimi i politikave të zbutjes dhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të risqeve.
2. Inkurajimi i turizmit dhe i trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
3. Investimi në problemet e rinisë, arsim dhe aftësim.

Programi aktualisht ka linçuar dy thirrje për projektpropozimin.

Alokimet për vitin 2019 për programin Mali i Zi-Shqipëri, përsëri të financuara nga një grant përmes instrumentit IPA II me vlerë 1,7 milionë euro për të dyja vendet, duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të të dy shteteve, bashkërisht është 300 mijë euro, arrijnë vlerën 2 milionë euro. Në total kontributi i BE-së për zbatimin e përbashkët të programit Mali i Zi-Shqipëri për periudhën 2014-2020 kap vlerën 11,9 milionë euro. Alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Malit të Zi dhe Komisionit European.

Zonat përfituese do të jenë: në Malin e Zi, Andrijevicë, Berane, Petnicë, Plavë, Guci, Rozhajë, Podgoricë, Cetinje, Danilovgrad, Budva, Bar dhe Ulqin; në Shqipëri, qarku i Shkodrës, qarku i Lezhës dhe bashkia e Tropojës. Programi në fjalë mbulon një territor prej 11 970 km² me një popullsi prej rreth 750 mijë banorë. Duke marrë parasysh aspektet e ndjeshme që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe në zhvillimin e saj të qëndrueshëm programi do të ketë këto fokuse prioritare:

1. Nxitja e turizmit dhe trashëgimia kulturore dhe natyrore.
2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe e lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i riskut.
3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit.

Aktualisht programi ka lançuar dy thirrje për projektpropozime.

Zonja kryetare, kjo ishte në mënyrë koncize dhe të përmbledhur se cilat do të ishin alokimet midis nesh dhe 3 vendeve fqinjë për IPA II, për vitin 2019.

Faleminderit!

Senida Mesi – Zoti Mazi, të falënderoj për prezantimin!

Ne ju kemi pritur edhe më parë në Komisionin e Integritit European, pasi është komisioni më i rëndësishëm dhe i vetmi në lidhje me çështjet e integritit. Për këto arsye, nga ju si kryenegociator, do të dëshironim t'ju kishim sa më prezent në komisionin tonë sa herë të thirreni apo sa herë ju vetë ta gjykoni të arsyeshme për të na bërë prezantime para Komisionit të Integritit European, para Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me ecurinë e procesit të negociimit, të problematikave apo aty ku ju e shihni si të nevojshme që Kuvendi duhet të ndërhyjë për të bërë pikërisht shtysën dhe rolin e tij kontrollues dhe monitorues të ekzekutivit me qëllim që të jemi në linjë me ato që ne kemi marrë përsipër.

Po ashtu, edhe sa i takon pjesës së rezolutës, të cilën ne e aprovuam në shtator të këtij viti, në lidhje me planin e veprimit, kushtet apo parakushtet për fillimin e Konferencës së Parë Ndërqeveritare për përgatitjen e kuadrit negociator. Kështu që do të donim realisht ta konsideronit si një homolog, si një bashkëpunëtor në lidhje me punën tuaj dhe në këtë proces shumë të rëndësishëm.

Po, zoti Mazi.

Zef Mazi – Faleminderit!

Për dijeninë tuaj, të anëtarëve të komisionit, unë sot kam pasur të gjithë ditën takime dhe, për hir të njoftimit të djeshëm për t'u paraqitur sot në komision, i kam anuluar të gjithë. Kjo nuk besoj se do të ndodhë, kjo nuk krijon precedent. Mospjesëmarrja në raste të tjera ka ndodhur për shkak se jemi njoftuar dy ditë ose një ditë përpara, ndërkohë që programi, përfshirë udhëtimet jashtë shtetit nëpër kryeqytete, bëhet minimumi dy javë përpara.

Ju lutem, unë vij në çdo rast që komisioni e shikon të arsyeshme se duhet të vij, pra në çdo rast, por, ju lutem, më njoftoni në kohë, që të koordinoj programet dhe takimet. Jam shumë i gëzuar që parlamenti ka vëmendje kaq të madhe, komisioni ka rëndësi të madhe, dimensionin parlamentar për tërë integrimin është tepër i rëndësishëm, për çka unë nuk kam nevojë të flas, sepse ju e dini vetë.

Desha të shtoja diçka, që e thashë edhe në një komision tjetër, po sot paradite, në lidhje me një pyetje që bëri deputeti Gjoni, i cili kërkoi që të ketë më shumë informacion nëpër komisione për ecurinë e punës në zbatimin e IPA-ve. Ne po punojmë për IPA-3, që fillon në vitin 2021. Janë bërë planet përkatëse të fishave të veprimit, janë dërguar në komision dhe pritet njoftimi zyrtar i komisionit. Pasi të vijë njoftimi zyrtar i komisionit, ne duhet të kthejmë përgjigje për vitin 2021 deri në 15 shkurt të vitit që vjen dhe për vitin 2022 deri në datën 15 mars të vitit 2021.

Në datën 3 dhjetor, për dijeninë e komisionit, u zhvillua komiteti i monitorimit i IPA 2 midis Shqipërisë dhe Komisionit Europian. Në atë mbledhje unë mora pjesë e drejtova, fola, folën dhe drejtorët përkatës të komisionit. Mbledhja zgjati 4 orë dhe do të ketë dhe një përmbledhje të asaj që u tha, pra procesverbalet e mbledhjes. Sa të na vijë kjo unë do ta ndaj me Komitetin e Parlamentit për Integrimin Europian, siç do ta bëj edhe për Komisionin e Politikës së Jashtme. Këtë i thashë zotit Gjoni, sepse ka të drejtë dhe kjo do të bëhet.

Senida Mesi – Ju falënderoj, zoti Mazi!

Ju e dini se çdo marrëveshje bashkëpunimi, sidomos me IPA-t, kalon për ratifikim në parlament, kështu që na takon edhe ne për të marrë informacionin. Unë dua të shpreh falënderimet e mia, si nënkryetare e komisionit, për gatishmërinë tuaj! Keni të drejtë kur thoni për kohën e njoftimit, por në këto kushte që po punojmë dhe ne dhe në kushtet e pandemisë edhe trajtimi i projektligjeve dhe ardhja nga Këshilli i Ministrave kanë një afat shumë të ngushtë kohor. Unë këtu gjej rastin të falënderoj edhe kolegët deputetë për gatishmërinë, sepse njoftimet edhe ne na vijnë në momentin fundit, të cilat duhet t'i lexojmë, t'i kuptojmë dhe të bëjmë pyetje dhe

diskutime, me qëllim që edhe me ju, që jeni pjesëmarrës, ne të dimë se çfarë t'ju pyesim dhe t'i kalojmë projektligje siç duhet, pavarësisht se shumë prej tyre janë kaluar me procedurë të shpejtuar dhe kohë rekord.

Sa u përket çështjeve të IPA-ve, IPA-2 dhe IPA 3, dhe për procesin e negocimit, ju do të merrni njoftimin në kohë dhe pasi të biem dakord me edhe me axhendën tuaj. Unë besoj se do të shihemi shpejt, këtë do ta diskutoj edhe me kryetaren, pra mund të mblidhemi brenda këtij muaji, në varësi edhe të axhendës suaj, për të na bërë një rezymë si po mbyllet ky vit në lidhje me çështjen e negocimit. Besoj se gjej mirëkuptimin tuaj në lidhje me këtë çështje. Nëse axhenda juaj jua lejon, përndryshe pastaj do të takohemi në janar, për të bërë një rezymë të të gjithë vitit dhe sfidave që kemi përpara.

Zoti Gjoni ka kërkuar fjalën.

Ralf Gjoni - Faleminderit!

Faleminderit, zoti Mazi, për faktin që ngritët një shqetësim, të cilin unë e kisha ngritur në Komisionin e Politikës së Jashtme! Dua të përfitoj nga rasti t'ju bashkëngjitëm edhe juve në atë që thatë, si ndoshta deputeti sherranik i opozitës këtu në parlament, ky është një komisioni, që, edhe pse ne jemi shumë kritikë si opozitë, kur vjen puna te integrimi evropian i Shqipërisë, ne jemi një trup, në fund të fundit, se nuk duhet të ketë ndarje maxhorancë e opozitë për një çështje kaq madhorë, siç është integrimi evropian.

Përfitoj nga rasti, meqë është hera e parë që unë jam prezent me zotin Mazi këtu në komision, t'i uroj zotit Mazi mbarësi dhe suksese në këtë pozicion kyç për të ardhmen e integritit evropian! Jam shumë i lumtur edhe për shkak të historisë së mëparshme me ambasadorin Mazi në Londër, që një ambasador dhe diplomat dhe një profesionist i këtij kalibri është vendosur dhe ka pranuar të shërbejë në këtë pozicion të rëndësishëm për integrimin evropian. Dua t'i garantoj zotit Mazi se nga ne, si opozitë, pavarësisht se kemi kritika të herë pas here në mbledhjet e ardhshme, do të ketë mbështetjen e plotë për ta avancuar më tej këtë axhendë të integritit evropian, e cila, fatkeqësisht, jo për fajin tuaj, është marrë peng vite me radhë nga axhendat e ngushta politike të të gjitha palëve.

Faleminderit!

Senida Mesi – Zoti Papa, fjala për ju.

Kostaq Papa - Faleminderit!

Përshëndes me këtë rast kryenegociatorin, zotin Mazi, që është në mbledhjen e komisionit!

Unë do të ndalem në dy-tri probleme që kanë lidhje me këto marrëveshje. Këto marrëveshje janë të rëndësishme sidomos për Shqipërinë, që është në negociatat e fundit për të qenë anëtare e BE-së.

Arsyeja tjetër është se, duke qenë se bëhet fjalë për republikat rreth nesh sigurisht, pra vendet rreth nesh, sigurisht që Shqipëria është më e interesuar, sepse rreth nesh kemi popullsia shqiptare, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe Kosovë, kështu që interesimi i mbarëvajtjes së këtyre marrëveshjeve ka të bëjë me shqiptarët.

Ajo që dua të theksoj unë është që ka dy fenomene që duhet t'i shohim, së pari, në lidhje me alokimin e fondeve që bëhen brenda Shqipërisë, mund të ketë ndonjë precedent, i cilimund të ketë lidhje jo me shpërndarjen publike, por me shpërndarjen nga individët privatë, ku mund të ketë ndonjë problem shpërndarjeje në lidhje me aspekte militanteske.

Së dyti, a ka ndjekur ministria ndonjë mënyrë ose metodologji edhe popullsinë jashtë Shqipërisë, për shembull në Mal të Zi, ose Maqedoni, ku shumica e popullsisë në këto rajonë është shqiptare? Pra, në rajonet kufitare, ku do të zbatohen këto marrëveshje, a do të ndikojnë këto fonde në zhvillimin dhe mirëqenien e popullsisë shqiptare, e jetës së tyre, apo ka triblime nga qeveritë e këtyre vendeve për të vajtur tek ata pak njerëz që kanë pjesa tjetër e popullsisë? A ka ministria jonë ndonjë mënyrë për të kontrolluar nëse në Plavë, Guci ose Ulqin fondi shkon aty ku duhet dhe nuk shkon te një pjesë tjetër e popullsisë?

Mendimi im është pro për marrëveshjen.

Pres një mikropërgjigje.

Senida Mesi – Po, zoti Mazi.

Zef Mazi – Faleminderit!

Së pari, falënderoj deputetin Gjoni për fjalët e ngrohta që tha në adresën time! Vërtet njihemi prej shumë vitesh, kemi qenë në pozicione të ndryshme, por kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë! Faleminderit për mbështetjen që jep për procesin e integritit! Është absolutisht e rëndësishme, pasi në Unionin Evropian nuk integrohen partitë politike, integrohet vendi. Kjo duhet të jetë prioritare për të gjithë, prandaj mbështetja e të gjitha kategorive për këtë proces nuk duhet të mungojë, duhet të jetë reale dhe e plotë.

Në lidhje me pyetjet e zotit Papa. Të tëra projektpropozimet që vijnë në kuadrin e IPA-ve, qofshin këto të nivelit kombëtar ose ndërkuftar, bëhen mbi bazën e një shkëmbimi eksperience

në institucionet qendrore ose lokale, përfshirë edhe OJQ-të lokale, sipas kapitujve që ka caktuar unioni, tri fushave prioritare, siç jua lexova.

Unë e kuptoj, është me të drejtë pyetja e alokimit të fondeve, por kërkesat vijnë nga zonat, i koordinon dhe grumbullon Ministria jonë e Jashtme dhe i paraqet në mënyrë zyrtare pranë delegacionit të Unionit të Komisionit European në vendet përkatëse këtu te ne, në Podgoricë ose në Shkup. Vlerësimet e këtyre propozimeve i bën komisioni përmes delegacionit të Unionit European. Ne nuk mund të kontrollojmë, sepse këtë kontroll në një vend tjetër e bën delegacioni i Unionit European atje, siç e bën këtu delegacioni i Unionit European përmes Soreca-ës dhe ekipit të madh që ka ai.

Domethënë, para se të miratohen projektet, edhe një herë i analizon mirë komisioni, shkojnë nga delegacionet përkatëse në Bruksel dhe kthehen mbrapsht ku miratohen. Atëherë njoftohen palët, 4 shtetet në rastin tonë në marrëveshjet dypalëshe me to, që komisioni ka miratuar projektet 1, 3, 7 dhe 11. Kjo është procedurë e rregullt. Ne, në fakt, nuk kemi pse të mos besojmë që këtë kontroll e bën në mënyrë shumë egzigjente, strikte delegacioni i Komisionit European. Është e vështirë të mendohet që ato nuk kontrollohen nga komisioni në Bruksel, veçanërisht kur është problemi për shpenzime financiare.

Para 3 ditësh, ditën e enjte të javës së kaluar, isha në një mbledhje shumë të rëndësishme të Forumit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor, dhe e ndaj me komisionin. Në këtë mbledhje mori pjesë Guvernatori i Bankës së Investimeve të Këshillit të Europës, gjithashtu mori pjesë edhe Komisioneri Varhelyi. Fjalë për fjalë, Komisioneri Varhelyi tha: “Për vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat në mënyrë të padiskutueshme janë pjesë e Unionit European, do të duhen projekte infrastrukturore të një dimensionit madhor për vitet që parashikojmë” dhe dha shifrën deri në 20 miliardë së paku, “që infrastruktura e të gjitha vendeve të jetë e tillë, që kur këto të hyjnë Union, sipas ecurisë së shpejtësisë në negociatat e Unionit European, infrastruktura totale energjetike, e rrugëve, e elektrikut e të tjerë do të jetë në të njëjtin nivel me Unionin European”. Pra, grantet që japin, i kontrollojnë po ata vetë, ndërkohë propozimet tona vijnë nga baza. Kështu është procedura, se Unioni nuk lejon ndryshe.

Ju përmendët temin “metodologji” për kontroll dhe përsëri metodologjia më e mirë është mbledhjet vjetore që bëhen midis nesh dhe Komisionit European, analizohet një për një sipas një programi shumë të detajuar se çfarë është bërë për secilin projekt ose grup projektësh.

Faleminderit!

Senida Mesi – Ju falënderoj, zoti Mazi!

Në fakt, ka diskutime të hershme të këtij komisioni në lidhje me përthithjen e projekteve, pasi, nga njëra anë, flitet që do të kemi më tepër akses në momentin e bërjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare; do të kemi edhe fonde të shtuara, fonde kohezioni dhe fonde të tjera, ku Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut do të kenë akses në këto fonde, gjithçka që do të ngelet pastaj do të kalojë sa për shoqëritë civile, sa për biznesin, universitetin dhe akademinë. Shqipëria do të mundohet të bëjë projekte dhe të përthithë sa më shumë fonde.

Zoti Papa, sigurisht për këto projekte, baza dhe thelbi është konkurrueshmëria, pra thirrjet janë publike. Sa më të konkurrueshëm të jemi ne, sa më shumë projekte të denja dhe të afta të dimë të shkruajmë ,qoftë nga ana e shoqërisë civile, akademisë, biznesit, pasi do të jenë akses direkt i fondeve për bizneset, por edhe qeveria shqiptare, aq më të suksesshëm do të jemi ne në përthithjen e këtyre fondeve dhe në bërjen e atyre gjërave, që realisht vlejné për një Shqipëri drejt Bashkimit European.

Më falni! Zoti Sterjovski, dëshironi fjalën?

Vasil Sterjovski – Faleminderit, zonja nënkryetare!

Falënderoj ambasadorin Mazi, për shpjegimin që dha në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit të fondeve IPA me Maqedoninë, Kosovën dhe Malin e Zi!

Thjesht kam një rekomandim në lidhje me prioritetet. Kur diskutohen prioritetet midis dy vendeve, konkretisht me Maqedoninë, pastaj me Kosovën dhe Malin e Zi, programi ose çfarë do të mbështeten nga këto fonde, besoj që, përveç ndikimit në mjedis, ndryshimeve klimaterike, por edhe nxitja e turizmit e të tjera, duhet të përfshijnë si prioritete edhe investimet konkrete në infrastrukturë, sidomos në atë rrugore, ujësjellës-kanalizime, menaxhimin e mbetjeve urbane, sidomos për pjesët rurale të vendit tonë, pasi, siç e dimë, zonat rurale janë të pazhvilluara dhe kanë nevoja jetike për investime në infrastrukturë. Besoj se këto fonde duhet të shkojnë më shumë për pjesën e infrastrukturës në gjëra të prekshme dhe të dukshme, se, nga sa kemi parë deri më tani, pjesa më e madhe e fondeve IPA shkojnë më shumë për trajnime dhe seminare apo për publikime. Pra, ka shumë pak gjëra të prekshme që mbeten. Ndaj, mendoj se, meqë e kemi ne vetë në dorë, mund t'i mundësojmë prioritetet se ku duhet të fokusohet ky program. Besoj se në të ardhmen, se tani kaloi viti 2019, kur të diskutohen prioritet, të diskutohen gjëra konkrete, që bashkitë të mund të aplikojnë për një infrastrukturë konkrete, sidomos për zonat rurale.

Senida Mesi – Faleminderit, zoti Sterjovski!

Besoj se do të kemi mundësinë të shohim se ku janë të fokusuar edhe planet, edhe IPA III, për sa kohë që është në një proces negocimi dhe do të kemi së shpejti edhe një vendimmarrje, për këtë arsye thashë që komunikimi me Komisionin e Integritit European duhet të shihet nga zoti Mazi, nga kryenegociatori, si një nga komisionet partner në lidhje me këtë rrugëtim, jo vetëm për të bërë me dije se ku jemi, por për të bërë me dije edhe punën, edhe procesin dhe të gjithë angazhimin e komplet strukturës së negocimit të Shqipërisë me Bashkimin European, por edhe për të marrë rekomandime dhe sugjerime edhe nga anëtarët deputetë, kolegë deputetë të nderuar të këtij komisioni.

Nëse më lejoni dhe nuk keni pyetje të tjera, duke i uruar shumë suksese ambasadorit dhe gjithë ekipit të tij për procesin e negocimit, suksesi i tij është automatikisht është sukses edhe yni! Duhet të punojmë të gjithë së bashku për suksesin e Shqipërisë dhe për integrimin sa më parë të saj në BE. Të hapim Konferencën e Parë Ndërqeveritare dhe të fillojmë pastaj, në bazë edhe të strukturës dhe kornizës së negocimit, hap pas hapi me të gjithë kapitujt.

Di që zoti Mazi, me të gjithë ekipin e tij, pavarësisht hapjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare, po e vazhdon punën njësoj, sikurse edhe ne duhet punojmë fort që të zhvillohet Konferenca e Parë Ndërqeveritare të bërë, me pjesën e grupeve teknike, me komisionin, me kapituj të veçantë, ndaj do të rekomandoja që ju të vazhdoni me këtë ritëm, me qëllim që ne të jemi gati në çdo moment që Bashkimi European të japë dakordësinë e tij për Konferencën e Parë Ndërqeveritare.

Të nderuar kolegë deputetë, do të doja të kalonim në miratimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2019”.

Kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Të njëjtën gjë do të bëjmë edhe për dy projektligjet e tjera. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit European për

programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Kosovë-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2019”.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në lidhje me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Maqedonia e Veriut-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2019”, kush është dakord në parim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Komisioni i Integritetit Europian miraton të tria projektligjet lidhur me ratifikimin e këtyre marrëveshjeve IPA II për bashkëpunimin Mali i Zi –Shqipëri, Kosovë-Shqipëri dhe Maqedonia e Veriut-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2019.

Zoti Mazi, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe përgjigjet që dhatë! Besoj se do të rishihemi sërish lidhur me çështjet që do të trajtoni, që janë pjesë e përgjegjësisë kryesore e këtij komisioni.

Suksese!

Të nderuar kolegë,

Kemi edhe një çështje tjetër, miratimin e kalendarit të Komisionit të Integritetit Europian për periudhën 30 nëntor -25 dhjetor. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Jeni dakord me miratimin e procesverbaleve të datave 9, 17 dhe 20 nëntor? Besoj se i keni lexuar. Keni ndonjë koment ose pyetje?

Të gjithë dakord.

Ju faleminderit, të gjithëve!

Kalofshi një ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA